

RELACION

PËR PROJEKTLIGJIN

PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË ARTISTËVE PERFORMUES PAS NDËRPRERJES SË VEPRIMTARISË ARTISTIKE SKENIKE

I. QËLLIMI I PROJEKTAKTIT DHE OBJEKTIVAT QË SYNOHEN TË ARRIHEN

Projektligji “Për trajtimin financiar të artistëve performues pas ndërprerjes së veprimtarisë artistike skenike” ka për qëllim përcaktimin e kushteve, kriterëve dhe procedurave për përfitimin e një trajtimi financiar të posaçëm nga punonjësit që kanë ushtruar profesione artistike performuese në institucionet publike të artit dhe kulturës, pas përfundimit të marrëdhënies së punës dhe të veprimtarisë së tyre profesionale skenike dhe deri në lindjen e së drejtës për pension pleqërie, pension invaliditeti ose pension familjar, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore.

Projektligji synon të krijojë një skemë të posaçme dhe të unifikuar të trajtimit financiar për kategoritë e artistëve performues të përcaktuara shprehimisht në të, duke marrë në konsideratë natyrën e veçantë të profesioneve artistike që lidhen drejtpërdrejt me interpretimin fizik ose vokal në skenë, kërkesat e veçanta profesionale të ushtrimit të tyre dhe kohëzgjatjen e aftësisë për vijimin e veprimtarisë artistike skenike.

Nëpërmjet kësaj skeme synohet të sigurohet një mbështetje financiare për artistët performues që kanë përmbushur kriteret e përcaktuara në ligj lidhur me moshën, periudhën e performancës skenike dhe periudhën e sigurimit shoqëror, duke krijuar një mekanizëm të posaçëm për periudhën ndërmjet përfundimit të marrëdhënies së punës dhe lindjes së së drejtës për pension.

Skema synon gjithashtu të garantojë vazhdimësinë e mbulimit me sigurime shoqërore dhe shëndetësore gjatë periudhës së përfitimit të trajtimit financiar, nëpërmjet përballimit nga Buxheti i Shtetit të kontributeve përkatëse, në përputhje me përcaktimet e këtij ligji dhe legjislacionin në fuqi për sigurimet shoqërore.

Objektivat kryesore që synohen të arrihen nëpërmjet këtij projektligji janë:

- krijimi i një skeme të posaçme të trajtimit financiar për artistët performues që kanë ushtruar profesionet e përcaktuara shprehimisht në projektligj në institucionet publike të artit dhe kulturës;
- përcaktimi i qartë i kategorive të profesioneve artistike performuese që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit, duke marrë në konsideratë natyrën e veçantë të interpretimit fizik dhe vokal në skenë;
- përcaktimi i kriterëve minimale dhe kumulative për lindjen e së drejtës për trajtim financiar, lidhur me moshën, periudhën e performancës skenike dhe periudhën e sigurimit shoqëror, me kriterë të diferencuara sipas kategorisë së profesionit artistik performues;
- përcaktimi i një mekanizmi të qartë për identifikimin dhe verifikimin e subjekteve që plotësojnë kushtet e përfitimit dhe për kalimin e tyre në skemën e trajtimit financiar;
- përcaktimi i plotësimit të kushteve të përfitimit si shkak i posaçëm ligjor për përfundimin e marrëdhënies së punës, për efekt të kalimit në skemën e trajtimit financiar, duke respektuar të drejtat dhe garancitë procedurale të punëmarrësit sipas legjislacionit në fuqi;
- përcaktimi i masës së trajtimit financiar në mënyrë të diferencuar sipas periudhës së përfitimit, duke parashikuar 70 për qind të pagës bruto mujore të përfituar në muajin e fundit të marrëdhënies së punës për pesë vitet e para dhe, pas kësaj periudhe, 50 për qind të pagës neto mujore të referencës për profesionin dhe kategorinë përkatëse;
- garantimi i vazhdimësisë së periudhës së sigurimit gjatë kohës së përfitimit të trajtimit financiar, nëpërmjet përballimit nga Buxheti i Shtetit të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore;
- përcaktimi i rregullave dhe procedurave të qarta për administrimin, financimin dhe pagesën e trajtimit financiar, si dhe për bashkëpunimin dhe shkëmbimin e informacionit ndërmjet institucioneve përgjegjëse;
- garantimi i një trajtimi të njëtrajtshëm, transparent dhe të verifikueshëm për të gjithë subjektet që plotësojnë kushtet e përcaktuara në ligj;
- parashikimi i rregullave për ndërprerjen e përfitimit në rastet e përcaktuara në ligj, veçanërisht me lindjen e së drejtës për pension pleqërie, pension invaliditeti ose pension familjar;
- krijimi i mundësisë për ruajtjen dhe transmetimin e përvojës profesionale të artistëve përfitues, nëpërmjet angazhimit të tyre, sipas kërkesës së institucionit publik të artit dhe kulturës dhe në përputhje me aftësitë dhe

mundësitë e tyre, në veprimtari trajnuese, promovuese, artistike, kulturore ose mentorim profesional.

Në këtë mënyrë, projektligji synon të krijojë një kuadër të posaçëm, të qartë dhe të qëndrueshëm për trajtimin financiar të artistëve performues pas përfundimit të marrëdhënies së punës dhe të veprimtarisë së tyre profesionale skenike, duke harmonizuar nevojën për mbështetje financiare të kësaj kategorie me vazhdimësinë e sigurimit shoqëror, respektimin e garancive procedurale në marrëdhëniet e punës dhe administrimin e përgjegjshëm të fondeve publike.

II. VLERËSIMI I PROJEKTAKTIT NË RAPORT ME PROGRAMIN POLITIK TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, ME PROGRAMIN ANALITIK TË AKTEVE DHE DOKUMENTE TË TJERA POLITIKE

Projektligji nuk është parashikuar në Programin e Përgjithshëm Analitik të Projektakteve që do të paraqiten për shqyrtim në Këshillin e Ministrave për vitin 2026.

III. ARGUMENTIMI I PROJEKTAKTIT LIDHUR ME PËRPARËSITË, PROBLEMATIKAT, EFEKTET E PRITSHME

Projektligji “Për trajtimin financiar të artistëve performues pas ndërprerjes së veprimtarisë artistike skenike” propozohet në kushtet e nevojës për të krijuar një kuadër të posaçëm ligjor për trajtimin financiar të punonjësve që kanë ushtruar profesione artistike performuese në institucionet publike të artit dhe kulturës dhe që, për shkak të natyrës së veçantë të këtyre profesioneve, përfundojnë veprimtarinë e tyre artistike skenike përpara lindjes së të drejtës për pension, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore.

Profesionet artistike performuese të përfshira në projektligj lidhen drejtpërdrejt me interpretimin fizik ose vokal në skenë dhe karakterizohen nga kërkesa të veçanta profesionale, fizike dhe vokale. Për shkak të këtyre specifikave, aftësia për ushtrimin e drejtpërdrejtë të profesionit në skenë mund të kufizohet përpara moshës së zakonshme të pensionit. Për këtë kategori punonjësish krijohet, për rrjedhojë, nevoja për një mekanizëm të posaçëm që mbulon periudhën ndërmjet

përfundimit të marrëdhënies së punës për shkak të përmbushjes së kushteve të përcaktuara në ligj dhe lindjes së të drejtës për pension.

Projektligji synon të vendosë një skemë të përcaktuar qartë, me kritere objektive dhe të verifikueshme, duke e lidhur të drejtën për trajtim financiar me moshën, periudhën e performancës skenike dhe periudhën e sigurimit shoqëror. Këto kritere zbatohen në mënyrë kumulative dhe diferencohen sipas kategorisë së profesionit artistik performues, duke reflektuar karakteristikat dhe kërkesat e ndryshme të profesioneve të përfshira në fushën e zbatimit të ligjit.

Një nga përparësitë kryesore të projektligjit është përcaktimi shprehimisht i kategorive profesionale që përfitojnë nga skema. Në fushën e zbatimit përfshihen profesionet e interpretimit fizik në skenë, konkretisht akrobati, balerini dhe valltari, si dhe profesionet e interpretimit vokal në skenë, konkretisht këngëtari lirik-solist dhe këngëtari-korist. Ky përcaktim synon të sigurojë qartësi në zbatimin e ligjit dhe të shmangë zgjerimin e papërcaktuar të kategorive përfituese. Një tjetër element i rëndësishëm është diferencimi i kushteve të përfitimit sipas natyrës së profesionit. Për profesionet e interpretimit fizik në skenë parashikohet mosha 47 vjeç, së bashku me të paktën 15 vjet periudhë të performancës skenike dhe 15 vjet periudhë sigurimi shoqëror. Për këngëtarin lirik – solist parashikohet mosha 57 vjeç, të paktën 20 vjet periudhë të performancës skenike dhe 20 vjet periudhë sigurimi shoqëror, ndërsa për këngëtarin – korist parashikohet mosha 57 vjeç, të paktën 20 vjet periudhë të performancës skenike dhe 25 vjet periudhë sigurimi shoqëror. Kjo diferencë synon të pasqyrojë specifikat profesionale dhe kërkesat e veçanta të secilës kategori.

Projektligji parashikon që plotësimi i kushteve të përcaktuara në ligj të përbëjë shkak të posaçëm ligjor për përfundimin e marrëdhënies së punës, për efekt të kalimit në skemën e trajtimit financiar. Ky mekanizëm synon të sigurojë një lidhje të qartë ndërmjet përfundimit të veprimtarisë artistike skenike dhe fillimit të trajtimit financiar, duke garantuar njëkohësisht respektimin e të drejtave dhe garancive procedurale të punëmarrësit, sipas legjislacionit në fuqi.

Në këtë drejtim, projektligji përcakton një procedurë të posaçme administrative për identifikimin, verifikimin dhe kalimin e subjekteve përfituese në skemë. Institucionet publike të artit dhe kulturës kanë detyrimin të identifikojnë kryesisht punonjësit që plotësojnë kushtet, të verifikojnë periudhën e performancës skenike dhe periudhën e sigurimit shoqëror dhe, pas përfundimit të verifikimit, të

përcjellin aktin dhe dokumentacionin përkatës pranë institucionit përgjegjës për administrimin dhe pagesën e trajtimit financiar. Kjo procedurë synon të sigurojë një zbatim të njëtrajtshëm, transparent dhe të kontrollueshëm të skemës.

Një përparësi tjetër e projektligjit është garantimi i vazhdimësisë së mbulimit me sigurime shoqërore gjatë periudhës së përfitimit të trajtimit financiar. Periudha gjatë së cilës subjekti përfiton trajtim financiar njihet si periudhë sigurimi për efekt të përfitimeve nga skema e sigurimeve shoqërore, ndërsa kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore përballohen nga Buxheti i Shtetit, sipas përcaktimeve të projektligjit dhe akteve nënligjore në zbatim të tij. Në këtë mënyrë, përfundimi i veprimtarisë artistike skenike nuk sjell ndërprerjen e mbulimit me sigurime shoqërore gjatë periudhës së trajtimit financiar.

Projektligji përcakton gjithashtu masën e trajtimit financiar dhe kohëzgjatjen e tij. Për pesë vitet e para nga fillimi i përfitimit, trajtimi financiar është 70 për qind e pagës bruto mujore të përfituar nga subjekti në muajin e fundit të marrëdhënies së punës. Pas kësaj periudhe, masa përcaktohet në 50 për qind të pagës neto mujore të referencës për profesionin dhe kategorinë përkatëse. Trajtimi financiar vijon deri në datën e lindjes së të drejtës për pension, në përputhje me legjislacionin në fuqi për sigurimet shoqërore.

Financimi i skemës parashikohet të kryhet nga Buxheti i Shtetit. Ky përcaktim synon të sigurojë një burim të unifikuar dhe të parashikueshëm financimi dhe të shmangë varësinë e përfitimit nga kapacitetet financiare të institucionit publik të artit dhe kulturës ku subjekti ka ushtruar veprimtarinë. Nëpërmjet akteve nënligjore do të përcaktohen më tej mënyra e llogaritjes, administrimit, financimit dhe pagesës së trajtimit financiar, si dhe procedurat për administrimin dhe pagesën e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.

Për të garantuar përdorimin e drejtë dhe të kontrollueshëm të fondeve publike, projektligji përcakton edhe rastet e ndërprerjes së përfitimit. Përfitimi ndërpritet kur subjektit i lind e drejta për pension pleqërie, pension invaliditeti ose pension familjar, kur konstatohet se përfitimi është marrë mbi bazën e dokumenteve ose deklarimeve të pavërteta, si dhe kur vetë përfituesi kërkon me shkrim ndërprerjen e tij. Përfitimet e marra padrejtësisht i nënshtrohen kthimit, në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Një element me rëndësi është edhe ruajtja e lidhjes së subjekteve përfituese me jetën artistike dhe kulturore. Projektligji parashikon mundësinë e angazhimit të tyre, me kërkesë të institucionit publik të artit dhe kulturës dhe pa shpërblim shtesë, deri në 250 orë në vit kalendarik, në veprimtari trajnuese, promovuese, artistike, kulturore ose mentorim profesional. Ky angazhim synon të mundësojë përcjelljen e përvojës dhe njohurive profesionale, mbështetjen e brezave të rinj dhe ruajtjen e trashëgimisë dhe traditës artistike. Në të njëjtën kohë, ky angazhim nuk përbën marrëdhënie pune dhe nuk mund të përdoret për të imponuar ushtrimin e rregullt të profesionit artistik performues për të cilin subjekti përfiton trajtimin financiar.

Projektligji parashikon gjithashtu dispozita kalimtare për personat që, në datën e hyrjes në fuqi të ligjit, plotësojnë kushtet e përfitimit. Këta persona identifikohen dhe verifikohen nga institucionet publike të artit dhe kulturës dhe kalojnë në skemën e trajtimit financiar sipas procedurave të përcaktuara në ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij. Kjo dispozitë synon të sigurojë vijimësinë dhe zbatimin efektiv të skemës që nga hyrja e saj në fuqi.

Efektet e pritshme të projektligjit janë kryesisht sociale, profesionale dhe financiare. Në aspektin social, pritet të rritet siguria ekonomike e artistëve performues që kanë ushtruar për një periudhë të konsiderueshme profesionet e përcaktuara në ligj dhe që përmbushin kriteret për përfitim. Në aspektin profesional dhe kulturor, krijohen kushte për ruajtjen dhe transmetimin e përvojës së tyre profesionale edhe pas përfundimit të veprimtarisë së rregullt skenike.

Në aspektin institucional, projektligji synon të rrisë qartësinë dhe parashikueshmërinë e procedurave që duhet të ndiqen nga institucionet publike të artit dhe kulturës, institucioni përgjegjës për administrimin dhe pagesën e trajtimit financiar dhe institucionet e sigurimeve shoqërore. Shkëmbimi periodik i informacionit ndërmjet institucioneve synon të mundësojë verifikimin e vazhdimësisë së përfitimit dhe ndërprerjen e tij në rastet e parashikuara nga ligji. Në aspektin financiar, zbatimi i projektligjit sjell efekte në Buxhetin e Shtetit, si për financimin e trajtimit financiar, ashtu edhe për përballimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për subjektet përfituese. Efektet financiare janë objekt i vlerësimit të veçantë buxhetor dhe pasqyrohen në raportin përkatës të vlerësimit të të ardhurave dhe shpenzimeve buxhetore.

Në tërësi, projektligji synon të krijojë një mekanizëm të posaçëm, të qartë dhe të qëndrueshëm për trajtimin financiar të artistëve performues pas përfundimit të veprimtarisë së tyre artistike skenike, duke marrë në konsideratë specifikat e këtyre profesioneve, kontributin e tyre të gjatë profesional dhe nevojën për të garantuar mbështetje financiare dhe vazhdimësi të mbulimit me sigurime shoqërore deri në lindjen e së drejtës për pension. Nëpërmjet përcaktimit të kriterëve objektive të përfitimit, procedurave të qarta administrative, burimit të financimit dhe mekanizmave të kontrollit e të ndërprerjes së përfitimit, projektligji synon të sigurojë një zbatim të drejtë, transparent dhe të qëndrueshëm të kësaj skeme, në përputhje me interesin publik dhe me parimet e administrimit të përgjegjshëm të fondeve publike.

IV. VLERËSIMI I LIGJSHMËRISË, KUSHTETUTSHMËRISË DHE HARMONIZIMI ME LEGJISLACIONIN NË FUQI VENDAS E NDËRKOMBËTAR

Projektligji propozohet në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të cilat përcaktojnë kompetencën e Kuvendit për të miratuar ligje dhe rregullat për nismën legjislative.

Projektligji është hartuar në përputhje me parimet dhe standardet kushtetuese, në veçanti me parimin e barazisë dhe të mosdiskriminimit, si dhe me detyrimin e shtetit për të garantuar mbrojtjen sociale dhe sigurimet shoqërore në përputhje me ligjin.

V. VLERËSIMI I SHKALLËS SË PËRAFRIMIT ME *ACQUIS COMMUNAUTAIRE* (PËR PROJEKTAKET NORMATIVE)

Projektligji nuk synon përafrimin me legjislacionin e BE.

VI. PËRMBLEDHJE SHPJEGUESE E PËRMBAJTJES SË PROJEKTAKTIT

Ky projektligj përmban 13 nene. Konkretisht:

Në nenin 1 përcaktohet qëllimi i projektligjit, i cili konsiston në përcaktimin e kushteve, kriterëve dhe procedurave për përfitimin e trajtimit financiar nga punonjësit që kanë ushtruar profesione artistike performuese në institucionet

publike të artit dhe kulturës, pas përfundimit të veprimtarisë së tyre profesionale skenike dhe deri në lindjen e të drejtës për pension pleqërie, pension invaliditeti ose pension familjar, sipas legjislacionit në fuqi për sigurimet shoqërore.

Në nenin 2 përcaktohen përkufizimet e termave kryesorë të përdorur në projektligj, duke përfshirë “institucionin publik të artit dhe kulturës”, “profesionin artistik performues”, “periudhën e performancës skenike”, “subjektin përfitues” dhe “trajtimin financiar”. Përkufizimet synojnë të përcaktojnë në mënyrë të qartë fushën e zbatimit të projektligjit dhe kuptimin e koncepteve kryesore të përdorura në të.

Në nenin 3 përcaktohen subjektet përfituese dhe profesionet artistike performuese që përfshihen në fushën e zbatimit të projektligjit. Në këtë kategori përfshihen profesionet e interpretimit fizik në skenë, konkretisht akrobati, balerini dhe valltari, si dhe profesionet e interpretimit vokal në skenë, konkretisht këngëtari lirik – solist dhe këngëtari – korist. Në këtë nen parashikohet gjithashtu që lista e institucioneve publike të artit dhe kulturës që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit, si dhe dokumentacioni dhe procedurat e verifikimit të periudhave të performancës skenike, të miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në nenin 4 përcaktohen kushtet për lindjen e së drejtës për përfitimin e trajtimit financiar, të cilat duhet të plotësohen në mënyrë kumulative dhe ndryshojnë sipas kategorisë së profesionit artistik performues. Për profesionet e interpretimit fizik në skenë parashikohet mosha 47 vjeç, të paktën 15 vjet periudhë të performancës skenike dhe 15 vjet periudhë sigurimi shoqëror. Për këngëtarin lirik – solist parashikohet mosha 57 vjeç, të paktën 20 vjet periudhë të performancës skenike dhe 20 vjet periudhë sigurimi shoqëror, ndërsa për këngëtarin – korist parashikohet mosha 57 vjeç, të paktën 20 vjet periudhë të performancës skenike dhe 25 vjet periudhë sigurimi shoqëror. Në këtë nen përcaktohet gjithashtu se trajtimi financiar përfitohet nga data e përfundimit të marrëdhënies së punës dhe vijon deri në lindjen e së drejtës për pension. Plotësimi i kushteve të përcaktuara në këtë nen përbën shkak të posaçëm ligjor për përfundimin e marrëdhënies së punës, për efekt të kalimit në skemën e trajtimit financiar, duke respektuar të drejtat dhe garancitë procedurale të punëmarrësit sipas legjislacionit në fuqi.

Në nenin 5 përcaktohet masa e trajtimit financiar dhe kohëzgjatja e përfitimit. Për pesë vitet e para nga data e fillimit të përfitimit, masa e trajtimit financiar është 70 për qind e pagës bruto mujore të përfituar nga subjekti në muajin e fundit të

marrëdhënies së punës. Pas përfundimit të kësaj periudhe, masa e trajtimit financiar është 50 për qind e pagës neto mujore të referencës për profesionin dhe kategorinë përkatëse, të përcaktuar sipas legjislacionit në fuqi. Trajtimi financiar vijon deri në datën e lindjes së të drejtës për pensionin e pleqërisë, pensionin e invaliditetit ose pensionin familjar.

Në nenin 6 përcaktohen rregullat për lindjen e së drejtës dhe procedurën për përfitim të trajtimit financiar. Institucioni publik i artit dhe kulturës, pas verifikimit të përmbushjes së kushteve, fillon procedurën për kalimin e punonjësit në skemën e trajtimit financiar dhe e njofton atë me shkrim për plotësimin e kushteve, procedurat që duhet të ndiqen, afatet dhe dokumentacionin përkatës. Pas përfundimit të verifikimit, institucioni nxjerr aktin për përfundimin e marrëdhënies së punës dhe kalimin e subjektit në skemën e trajtimit financiar, i cili i njoftohet subjektit përfitues dhe përmban, ndër të tjera, datën e përfundimit të marrëdhënies së punës, datën e fillimit të trajtimit financiar dhe informacionin mbi mjetet juridike të ankimit. Në këtë nen përcaktohet gjithashtu se e drejta për të përfutur trajtimin financiar nuk parashkruhet, si dhe parashikohet ndërprerja e përfitimit në rast të lindjes së të drejtës për pension. Institucioni përgjegjës për administrimin e përfitimit, në bashkëpunim me Institutin e Sigurimeve Shoqërore, verifikon periodikisht lindjen e të drejtës për pension dhe shkaqe të tjera të ndërprerjes së përfitimit, duke parashikuar shkëmbimin e informacionit çdo 6 (gjashtë) muaj.

Në nenin 7 përcaktohen rregullat për periudhën e sigurimit dhe kontributet. Periudha gjatë së cilës subjekti përfiton trajtim financiar njihet si periudhë sigurimi për efekt të përfitimit të pensionit të pleqërisë, pensionit të invaliditetit dhe pensionit familjar. Kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore për periudhën e përfitimit përballohen nga Buxheti i Shtetit dhe llogariten mbi bazën e pagës bruto të referencës për profesionin dhe kategorinë përkatëse, të përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave. Në këtë nen përcaktohet gjithashtu mënyra e derdhjes së kontributeve dhe përgjegjësia për administrimin, llogaritjen, deklarimin dhe pagesën e tyre.

Në nenin 8 përcaktohen rregullat për financimin e skemës. Trajtimi financiar dhe shpenzimet për kontributet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore përballohen nga Buxheti i Shtetit. Në këtë nen përcaktohet se mënyra e llogaritjes, administrimit, financimit dhe pagesës së trajtimit financiar, përcaktimi i institucionit përgjegjës për administrimin dhe kryerjen e pagesave, si dhe

procedurat për administrimin, deklarin dhe pagesën e kontributeve, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Gjithashtu, parashikohet angazhimi i subjekteve përfituese, me kërkesë të institucionit publik të artit dhe kulturës dhe pa shpërblim shtesë, deri në 250 orë në vit kalendarik, në veprimtari trajnuese, promovuese, artistike, kulturore ose mentorim profesional, në përputhje me aftësitë dhe mundësitë e tyre. Ky angazhim nuk përbën marrëdhënie pune dhe nuk mund të përfshijë detyrimin për ushtrimin e rregullt të profesionit artistik performues për të cilin subjekti përfiton trajtimin financiar. Kohëzgjatja, mënyra e organizimit, procedurat dhe rregullat e këtij angazhimi përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në nenin 9 përcaktohet procedura e kalimit në skemën e trajtimit financiar. Institucioni publik i artit dhe kulturës identifikon, kryesisht, punonjësit që plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 4, kryen verifikimin e të dhënave dhe dokumentacionit përkatës dhe, pas konstatimit të përmbushjes së kushteve, nxjerr aktin për kalimin e subjektit në skemën e trajtimit financiar dhe përcjell aktin dhe dokumentacionin përkatës pranë institucionit përgjegjës për administrimin dhe pagesën e trajtimit financiar. Institucioni përgjegjës, pas marrjes së dokumentacionit, kryen veprimet e nevojshme për caktimin dhe fillimin e pagesës së trajtimit financiar. Procedurat, afatet, dokumentacioni dhe mënyra e bashkëpunimit e shkëmbimit të informacionit ndërmjet institucioneve përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

Në nenin 10 përcaktohen rastet e ndërprerjes së përfitimit të trajtimit financiar. Përfitimi ndërpritet kur përfituesit i lind e drejta për pension pleqërie, pension invaliditeti ose pension familjar, kur konstatohet se përfitimi është marrë mbi bazën e dokumenteve ose deklarimeve të pavërteta, si dhe kur përfituesi kërkon me shkrim ndërprerjen e përfitimit. Në rast të përfitimit të padrejtë, shumat përkatëse kthehen në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Në nenin 11 përcaktohen dispozitat kalimtare. Personat që, në datën e hyrjes në fuqi të ligjit, plotësojnë kushtet e përcaktuara në nenin 4 identifikohen dhe verifikohen nga institucionet publike të artit dhe kulturës dhe kalojnë në skemën e trajtimit financiar sipas procedurave të përcaktuara në ligj dhe në aktet nënligjore në zbatim të tij.

Në nenin 12 përcaktohet detyrimi i Këshillit të Ministrave për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjit, brenda 6 muajve nga hyrja e tij në fuqi. Aktet

nënligjore do të përcaktojnë, ndër të tjera, listën e institucioneve publike të artit dhe kulturës që përfshihen në fushën e zbatimit të ligjit, dokumentacionin dhe procedurat e verifikimit, mënyrën e financimit dhe administrimit të skemës, si dhe procedurat e pagesës dhe të bashkëpunimit ndërmjet institucioneve.

Në nenin 13 përcaktohet hyrja në fuqi e ligjit, e cila parashikohet të jetë data 1 janar 2027.

VII. INSTITUCIONET DHE ORGANET QË NGARKOHEN PËR ZBATIMIN E AKTIT

Për zbatimin e këtij ligji ngarkohen ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, institucionet publike të artit dhe kulturës që përfshihen në fushën e zbatimit të këtij ligji, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, si dhe institucionet e tjera përgjegjëse për administrimin dhe ekzekutimin e fondeve publike, sipas përcaktimeve të këtij ligji dhe akteve nënligjore në zbatim të tij.

VIII. PERSONAT DHE INSTITUCIONET QË KANË KONTRIBUAR NË HARTIMIN E PROJEKTAKTIT

Projektligji “Për trajtimin financiar të artistëve performues pas ndërprerjes së veprimtarisë artistike skenike” është hartuar nga ministria përgjegjëse për artin dhe kulturën, në bashkëpunim me strukturat e varësisë.

Projektligji do të dërgohet për mendim në Ministrinë e Drejtësisë, Ministrinë e Financave, Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mirëqenies Sociale dhe Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Projektligji do t’i nënshtrohet edhe procesit të konsultimit publik, në përputhje me legjislacionin në fuqi për njoftimin dhe konsultimin publik. Në kuadër të këtij procesi do të merren në konsideratë kontributet, komentet dhe sugjerimet e paraqitura nga grupet e interesit, subjektet përfituese, institucionet publike të artit dhe kulturës dhe palët e tjera të interesuara.

Mendimet dhe sugjerimet e administruara gjatë procesit të konsultimit publik dhe ndërinstitutional do të vlerësohen gjatë finalizimit të projektligjit dhe, sipas rastit, do të reflektohen në përmbajtjen përfundimtare të tij.

IX. RAPORTI I VLERËSIMIT TË TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE BUXHETORE

Ky projektligj shoqërohet me efekte financiare për buxhetin e shtetit. Konkretisht,

- ❖ për vitin 2027, në masën 36 062 862 (tridhjetë e gjashtë milionë e gjashtëdhjetë e dy mijë e tetëqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë;
- ❖ për vitin 2028, në masën 7 376 754 (shtatë milionë e treqind e shtatëdhjetë e gjashtë mijë e shtatëqind e pesëdhjetë e katër) lekë;
- ❖ për vitin 2029, në masën 7 368 474 (shtatë milionë e treqind e gjashtëdhjetë e tetë mijë e katërqind e shtatëdhjetë e katër) lekë.

Efekti financiar i parashikuar më sipër është përlllogaritur mbi bazën e dispozitave të projektligjit dhe të dhënave të disponueshme në fazën e hartimit të tij. Ky efekt mund të pësojë ndryshime si rezultat i procesit të konsultimit publik dhe ndërinstitutional, nëse në vijim të këtij procesi do të propozohen dhe miratohen ndryshime në dispozitat e projektligjit që ndikojnë në numrin e subjekteve përfituese, kriteret e përfitimit, masën e trajtimit financiar, kohëzgjatjen e përfitimit apo elemente të tjera me ndikim financiar. Në një rast të tillë, përlllogaritja e efektit financiar do të rishikohet dhe përditësohet në përputhje me përmbajtjen përfundimtare të projektligjit.

MINISTRI

Blendi Gonxhja